



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Të enjten, më 15 janar, Mbrojtja e z. Pjetër Shala i dorëzoi Trupit Gjykses njoftimin se Mbrojtja ka përfunduar paraqitjen e provave. Gjatë paraqitjes së provave, Mbrojtja e z. Shala thirri 10 dëshmitarë për të dhënë dëshmi në sallë të gjyqit.

Sa u përket hapave të ardhshëm, pas njoftimit të Trupit Gjykses për mbylljen e procedurës së paraqitjes së provave, gjykatësit do të ftojnë Prokurorin e Specializuar dhe Mbrojtjen që të dorëzojnë Dosjet Gjyqësore Përfundimtare dhe caktojnë seancën për deklaratat përmbyllëse.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, dëshmitari i 40-të i thirrur nga Prokuroria filloi dhënien e dëshmisë të hënën dhe përfundoi të mërkurën. Dëshmitari ishte i mbrojtur dhe dha dëshmi përmes videolidhjes.

Sipas përmbledhjes që Prokuroria lexoi në sallë të gjyqit, dëshmitari kishte shërbyer në zonën operative të Dukagjinit gjatë periudhës përkatëse dhe dëshmia do të jepte informacion në lidhje me strukturën dhe marrëdhënien ndërmjet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës.

Të mërkurën, dëshmitari i 41-të i thirrur nga Prokuroria filloi dhënien e dëshmisë, po ashtu me masa mbrojtëse. Sipas Prokurorisë, dëshmitari është familjar i viktimës së vrasjes së paligjshme dhe i zhdukjes me dhunë nga Drenoci.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 15 janar, Trupi Gjykses urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, në vendime të ndara. Gjykatësit konstatuan për të dy të akuzuarit se vazhdon të ekzistojë rreziku që ata do të pengojnë ecurinë e procesit dhe të kryejnë krime të tjera kundër atyre që perceptohen se janë kundër UÇK-së, përfshirë dëshmitarët që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në këtë çështje. Trupi Gjykses vazhdon të jetë i mendimit se këto rreziqe mund të zvogëlohen mjaftueshëm vetëm me anë të kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara.

Më 11 janar, Administratorja e DHSK-së njoftoi Kryetaren e DHSK-së se kishte miratuar znj. Venkatesvari Alagendra si mbrojtëse të Salih Mustafës, e cila e zëvendëson mbrojtësin e mëparshëm të z. Mustafa, Xhulius von Bone.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 17 janar, Kryetarja e DHSK-së caktoi Gjykatësin e Vetëm për të mbikëqyrur zbatimin prej Administratores të paragrafëve specifikë të urdhrit për zhdëmtim të lëshuar kundër z. Mustafa nga Trupi Gjykses. Z. Mustafa u shpall fajtor për ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje të paligjshme, si krime lufte, nga Trupi Gjykses në dhjetor 2022 dhe Paneli i Gjykatës së Apelit la në fuqi verdiktet e fajësisë

1





në dhjetor 2023. Trupi Gjykses urdhëroi zhdëmtime për tetë viktimat pjesëmarrëse në proces, në shumën prej 207,000 eurosh.

Më 12 janar, Prokurori i Specializuar parashtrio një aktakuzë e cila, nëse konfirmohet, do të bashkojë çështjen gjyqësore të Sabit Januzit dhe Ismet Bahtijarit me atë të Haxhi Shalës.

Aktakuza e propozuar e përbashkët nuk shton akuza ose forma të përgjegjësisë të reja për asnjërin prej të akuzuarve, por përmban një numër të vogël pretendimesh faktike shtesë në lidhje me Januzin dhe Bahtijarin, si edhe sqarimet dhe përshtatjet gjuhësore të nevojshme për bashkimin e çështjeve gjyqësore.

Në çështjen gjyqësore të Isni Kilajt, më 11 janar, Paneli i Gjykatës së Apelit hodhi poshtë apelin e z. Kilaj kundër vendimit të Gjykatës të Vetëm që urdhëronte vazhdimin e paraburgimit.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

